




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIA PROTIV KORUPCIE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. 20/DPK  
 Nr. i faq. \_\_\_\_\_  
 Broj. stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages 02

Nr Prot. \_\_\_\_\_  
 Br Prot. 01-1403/13  
 Prot No. \_\_\_\_\_  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum 15-05-2013  
 Date \_\_\_\_\_

PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.05.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-235\13, për zyrtarin e lartë z. Ferki Fejza, Kryeshef Ekzekutiv, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-235/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ferki Fejza, Kryeshef Ekzekutiv në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar dhe pronarit në një kompani private "N.T.SH-ATOMIC" Prishtinë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.02.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Fejza, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Fejza, me datën 05.03.2013, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari

në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Kryeshefit Ekzekutiv në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe ka te regjistruar një Kompani privatë me emër “N.T.SH-ATOMIIC” Prishtinë, ku është pronarë dhe person i autorizuar.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se ne afat sa me të shpejtë do të bëjë ndryshimet dhe do ta autorizoj një person qe ta udhëheqë kompaninë e regjistruar, dhe do ta shmang çfarë do suate qe mund të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë me datën 30.04.2013, ka sjellë ne Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bartur tek personi i besuar te drejtën e drejtimit te kompanisë.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z.Ferki Fejza, Kryeshef Ekzekutiv në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor : zyrtari i lartë z. Ferki Fejza, ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit te interesit ne te cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

